




4089/20

10 AUG 2020

№-№-№



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 2 dhe nenit 20 paragrafi 5 të Rregullores MF-nr.04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenit 4 të Rregullores nr.01/2018/KG për ndarjen e subvencioneve, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e pestë të rregullt, e mbajtur më datën 05.08.2020, merr këtë:

V E N D I M Nr.36/2020/KG për ndarjen e subvencioneve

Neni 1

MIRATOHET Vendimi i Komisionit për vlerësimin e propozimit (nr.3134/20 nga 24.06.2020) për financimin e projekteve të paraqitura në Thirrjen publike për mbështetjen financiare të projekteve/programeve të organizatave joqeveritare në fushën e bujqësisë, të shpallur më datën 26.05.2020.

Neni 2

Aprovohet ndarja e mjeteve financiare nga subvencionet për fushën e bujqësisë, në një shumë totale prej 19.000 euro, për organizatat e mëposhtme:

1. Kooperativa bujqësore 11.000€
2. Shoqata OJQ "Pravo na život" 2.000€
3. Shoqata e gjuetarëve Graçanica 2.500€
4. N.T.SH MALA farm 3.500€

Neni 3

Detyrohet kryetari i komunës ta nënshkruajë me përfituesit e subvencioneve nga paragrafi 2 të Vendimit Kontratën për ndarjen e mjeteve financiare, në përputhje me dispozitat e Rregullores MF-nr.04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-tafelën zyrtare të komunës.


Kryesuesi i Kuvendit

Ljubisa Karadžić